REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 26/17
Datë/Datum. 21.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW

PSH. Nr. 26/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paqarizi – Referues, z. Blerim Dina - anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE **"El-Bau"** - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e Komunës së Vitisë"** me numër të prokurimit: VI657/17/070/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna e Vitisë (KV)**, më: 15.02.2017, mori këtë :

V E N D I M

I. **HUDHET,** poshtë si e palejuar ankesa OE **"El-Bau"** - Gjilan me nr. 26/17, kundër vendimit të AK - Komuna e Vitisë, për aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e Komunës së Vitisë"**, me numër të prokurimit: VI657/17/070/221, pasi i njëjti nuk ka arritur të dëshmoj interes juridik - material konform nenit 111 par. 1 pika 1.5 dhe 1.8 të LPP-së, lidhur me nenin 4.1.26 të LPP-së, për shkak se të njëjtit i tërhequr anëtari i konzorciumit.

II. **VËRTETOHET**, vendimi i AK - Komuna e Vitisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e Komunës së Vitisë"**, me numër të prokurimit: VI657/17/070/221. Autorizohet Autoriteti kontraktues që të vazhdoj me tutje me këtë aktivitet te prokurimit.

III. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankues "El-Bau" – Gjilan, hudhet poshtë si e pa lejuar, konform nenit 118 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik "El-Bau" – Gjilan, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 23.01.2017, me nr. të protokollit, 26/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE "Company Zuka Commerce" - Gjilan, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës: 06.02.2017 ka konstatuar se AK-ja, i ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe se pretendimi ankimor i parashtruar në ankesë është i paqëndrueshëm, për faktin se, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, konkretisht me datë: 30.12.2016, anëtari i konzorciumit OE "Global Project" i dërgon Komunës se Vitisë, Njoftimin për Tërheqje, në të cilin ndër të tjera thuhet:

"Ne tërhiqemi nga të gjitha obligimet tona dhe të gjitha detyrimeve në këtë tender, duke deklaruar dokumentet tona të pavlefshme dhe tërheqim autorizimin dhe mbështetjen tonë për partnerin lider në këtë konzorcium "El-Bau" Shpk nga Gjilani. Tërheqim të gjitha deklaratat tona, nënshkrimin, vulën, deklaratën nën betim, autorizimin për liderin dhe të gjitha autorizimet dhe dokumentet përcjellëse të dorëzuara për pjesëmarrje në këtë tenderim".

Eksperti shqyrtues, në raportin e tij, duke u bazuar edhe në interpretimet e KRPP-së, ka sqaruar se OE ankues "El-Bau", është i papërgjegjshëm, prandaj, i ka propozuar panelit shqyrtues, që ta hudhë poshtë ankesën e OE ankues si të palejuar dhe njëherit i ka propozuar panelit shqyrtues që ta aprovoj vendimin e AK-së, si të bazuar.

OE ankues "El-Bau" – Gjilan, përmes parashtresës ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

AK-ja, poashtu me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 15.02.2016, në të cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i autorizuar OE ankues, përfaqësuesi i AK-së. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE "EL - Bau" z. Pireva i cili deklaroj: Un sot i kam dërguar OSHP-së fjalën përfundimtare dhe kundërshtimin tonë me raportin e ekspertizës.

Me datë 27.12.2016 kemi bërë kërkesë KRPP-së, që të monitoroj lëndën, dhe poashtu kemi bërë kërkesë në Agjencionin Kundër Korrupsionit, si dhe këshillit të deputetëve për mbikëqyrjen e Financave.

Siç kemi parashikuar në kërkesë tonë, me datë 04.01.2017, na vjen një kërkesë nga drejtori i prokurimit se anëtari i konzorciumit "Global Project", ka bërë kërkesë për tërheqje nga tenderi.

Pasi jemi takuar me anëtarin e konzorciumit, anëtari jonë na ka shpjeguar se vëllau i tij dikush e ka takuar dhe i ka thënë se duhet të tërheket nga tenderi, ose përndryshe do prishim edhe marrëdhëniet familjare në rast, se nuk tërhiqet. OE i rekomanduar është për rreth 20.000€ më i shtrenjtë se oferta e jonë. E kundërshtojmë raportin e ekspertizës së z.Basha, sepse si fakt ka marr pyetjen e shpeshta sipas tij në KRPP nr. 17, e cila është e publikuar me 23.05.2011, kur në fuqi është ligji 03L-241.

Në anën tjetër qëllimisht i është shmangur nenit të rregullores së OSHP-së lidhur me ligjin 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimet i cili përmban parimet themelore dhe rregulla në zbatim në gjitha marrëdhëniet detyrimore, mirëpo ka aplikuar gabimisht neni 71 të LPP-së dhe neni 27 të UOPP-se, pasi në asnjë paragraf nenit 71 të LPP dhe neni 27 të UOPP-se, nuk parashikohet se si duhet vepruar kur tërhiqet një nga anëtarët e grupit.

Qëndrojmë pranë ankesës dhe kërkojmë nga panelit qe ta aprovoj ankesën tone si të bazuar dhe të anulohet vendim i AK-së dhe lënda të kthehet në Rivlerësim apo ritender.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-Komunës se Vitisë, z. Abazi i cili deklaroj: AK-ja, qëndron pranë vendimit të vet të shpallur për OE "Zuka", gjithashtu pajtohemi me mendimin e ekspertit.

Lënda për cilin kemi kontest është shumë e qartë, edhe në KRPP më kanë thirr për raportim dhe atje kemi raportuar dhe kemi pajtuar me departamentin e rregullave se në fazën e vlerësimit nëse njëri OE largohet nga konzorciumi, atëherë subjekti juridik si konzorcium në këtë rast "El Bau &Global Projekt" është OE i papërgjegjshëm. Kjo për shkak se ai në deklaratën e tij të datës 30.12.2016, tërhiqet nga gjitha detyrimet dhe deklaratat, përgjegjësitë dhe mbështetjen që e ka premtuar në konzorcimin e formuar me datë 23.12.2016, kështu që gjatë vlerësimit komisionit ka ardh në përfundim duke marr edhe praktikat dhe këshillat tjera që në këtë rast OE "El Bau&Global Projekt" është i papërgjegjshëm. Për arsye se me largimin e njërit partner ai është subjekt juridik i paqenë.

Andaj mendoj se kemi vepruar konform LPP-së dhe detyrimeve tona, pa pretendime subjektive ndaj njerëzve të caktuar, pavarësisht deklarimeve të OE që në 8 faqe merret me personalitetin time e një faqe për lëndën.

Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së, si të bazuar.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Basha i cili deklaroj: Gjatë vlerësimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit, anëtari i konzorciumit e ka dërguar një shkresë pranë AK-KK Viti, në të cilën është deklaruar se tërheq gjithë dokumentacionin i cili është dorëzuar për këtë tender në emër të liderit "El Bau".

Bazuar në dy interpretimet dhe praktikat e ngjashme të mëhershme ky konzorcium është i papërgjegjshëm për arsyen se cekur më lart. Kjo është arsyeja që kam propozuar që ankesa të hedhet poshtë si e palejuar për faktin se nuk mund të dëshmoj interes juridik material sipas nenit 4.1.26 dhe nenit 111 të LPP-së.

Anëtari i panelit Z. Dina pyeti përfaqësuesin e AK-së, se a keni ndonjë njoftim apo vlerësim me shkrim për këtë monitorim siç u deklaruat për këtë aktivitet te prokurimit.

Në përgjigje Z.Abazi deklaroj: Jo, ne jemi ftuar në bisedë, me ftesë z.Sami Uka, kam shkuar në KRPP dhe jam takuar me z. Limani dhe ata bazuar në përgjigjet e mia, nuk e menduan se është proces me shkelje.

Anëtari i panelit z.Dina pyeti përfaqësuesin e AK-së, a i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe formularit të tenderit OE "Elbau", pa partnerin që është tërhequr.

Në përgjigje z.Abazi deklaroj: Jo, si i vetëm nuk i plotëson kërkesat e dosjes.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues z.Pireva deklaroj: Ne mendojmë se plotësojmë kërkesat e dosjes edhe pa anëtarin e konzorciumit që është tërhequr.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikës pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se AK-ja në harmoni me nenin 59 të LPP-së, ka bërë Vlerësimin, Ekzaminimin dhe Krahasimin e ofertave, për faktin se gjatë vlerësimit të ofertave anëtari i konzorciumit OE "Global Project" është tërhequr nga konzorciumi me OE "El-Bau" dhe rrjedhimisht ky konzorcium është i papërgjegjshëm.

Paneli shqyrtues, gjithashtu bazuar në interpretimin e KRPP-së, përkatësisht tek pyetjet e shpeshta numër 17 ka sqaruar rastin kur tërhiqet anëtari i konzorciumit në të cilin thuhet se i tërë grupi duhet të refuzohet dhe tenderi i tyre të eliminohet nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit.

Andaj, paneli shqyrtues, duke u bazuar ne nenin 27 paragrafi 1 te Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, pika **c) ku thuhet se Anëtarët e grupit nënshkruajnë një deklaratë nga të gjithë për ta autorizuar partnerin udhëheqës të veprojë në emër të grupit**, nga kjo nënkuptohet se nëse ky konzorcium ushtron ndonjë ankesë ajo duhet të jetë e dorëzuar në emër të Konzorciumit dhe e nënshkruar nga partneri udhëheqës i autorizuar të veprojë në emër të grupit, e ne rastin konkret OE ankues "El-Bau", nuk ka me autorizim nga anëtari tjetër i konzorciumit OE "Global Project", dhe me këtë rast paneli shqyrtues, sqaron se AK-ja, me të drejt e ka eliminuar OE ankues nga ky aktivitet i prokurimit dhe pretendimi i OE ankues për shkelje të dispozitave të LPP-së të cekura në ankesë janë të paqëndrueshme dhe se me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP, në asnjë rrethanë OE ankues nuk ka arritur të dëshmoj interes Juridik e Material konform nenit 4.1.26 dhe nenit 111 të LPP-së, për faktin se anëtari i konzorciumit i është tërhequr, siç u cek edhe më lart.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues
Goran Milenkoviç

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELOVA RAZMATRANJE NABAVKE PRISHTINEJA REPUBLIKA KOSOVA